

## **Besion Ajazi**



**Datëlindja:**5.7.1985

**Vendlindja:** Gramsh

**E-mail:** Besion.Ajazi@parlament.al

### **Jetëshkrimi:**

Ka lindur në Gramsh më 5 korrik 1985. Pasi kreu studimet në Universitetin e Tiranës për gazetari (2004-2008), ka punuar si gazetar në Televizionin Publik Shqiptar, Departamenti i Programacionit dhe Aktualitetit. Më pas ka punuar në sektorin e politikës në Departamentin e Informacionit pranë kompanisë medietike “EDISUS”-spa dhe në po të njëjtin pozicion në “TOP Media” nga viti 2007 deri në vitin 2013. Ka ushtruar detyrën e këshilltarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste në Kuvendin e Shqipërisë nga dhjetori i vitit 2013 deri kur u zgjodh deputet i zonës së Gramshit.

Ka kryer një sërë kualifikimesh si: *European Broadcastin Union* për modelet e reja të transmetimit dixhital, prodhimit dhe trasmetimit të sinjalit televiziv në vitin 2013; për komunikimin dhe strategjitë e fushave elektorale nga fondacioni “Qemal Stafa”, si dhe Shkollën e Integritit European – Qeverisja dhe Llogaridhënia (2017 -2019) .

Gjithashtu, ka marrë pjesë në disa aktivitete shoqërore dhe politike, ku në vitin 2004 ka qenë kryetar i FRESH-it, shkolla e mesme “Qemal Stafa” dhe më pas ka mbajtur funksione të ndryshme brenda Partisë Socialiste.